



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 201/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Sali Toplica dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Srecko Cvetkovic në cilësinë e Kryetarit të OJQ-së “Sveta Trojica” nga fshati Pasjan Komuna e Gjilanit, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në seancën e mbajtur më 25.08.2010, mori këtë:

V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

A R S Y E T I M I

Z.Srecko Cvatkovic, Kryetar i OJQ-së “Sveta Trojica” nga Pasjani-Gjilan, ka parashtruar ankesë më datë 22.06.2010, me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve më datë 20.06.2010 në VV 3602D/01R, pas orës 13:00 ka ardhur deri te një turmë njerzish në këtë vendvotim, ku janë vërejtur votuesit të cilët kanë votuar ne orët e hershme të mëngjesit. Sipas tij anëtari i KVV-së Aleksander Stojkovic, ka marr fletëvotimet dhe i ka nxierr jashtë vendvotimit tek votuesit të cilët kanë votuar nëpër vetura, në largësi prej 50 deri 100 metra nga vendvotimi.

F A K T E T

Më 13 korrik 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Srecko Cvetkovic Kryetar i OJQ-së “Sveta Trojica” nga fshati Pasjan-Gjilan, parashtruesi i ankesës pretendon se gjatë procesit zgjedhor ka pasur parregullsi të ndryshme.

Si kryerës të supozuar parashtruesi i ankesës ka paraqitur anëtarin e KVV-së, Aleksander Stojkovic.

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi lidhur me rastin, por vetëm ka përmendur emrat: Danije Lalic, Nikolla Vasic, Nebojsa Mirkovic dhe Goran Dimic, si dëshmitar të mundshëm.

Mirëpo, në Raportin e Policisë së Kosovës nr.#6667, të datës 09.08.2010, theksohet se në lidhje me këtë ankesë kanë kontaktuar me Daniel Lazic, Nikola Vasic,

Nebojsa Mirkovic, por i vetmi ka qenë Nikola i cili ka parë që janë nxierrë jashtë 2-3 fletëvotime por nuk është në dijeni se kush e ka bërë këtë. Në këtë Raport thuhet se ata kanë kontaktuar me kryetarin e komisionit Slobodan Milosevic i cili ka deklaruar që, pasi që është bërë marrveshja me të gjithë anëtarët e komisionit, Slobodan Trajkovic i ka nxierr jashtë dy fletëvotimet deri te vetura në mënyrë që të votojnë Trifunovic Srboljub dhe bashkëshortja e tij Stana. Këtë e vërteton edhe vet Srboljub Trajkovic dhe biri i votuesit, Trifunovic Vojislav.

Policia ka kontaktuar me Aleksander Stojkovic i cili ka deklaruar që ka qenë anëtarë i KKZ-së dhe që tërë ditën ka qenë prezent në vendvotim, ku Slobodan Milosevic ka pyetur te gjithë anëtarët se a po e lejojnë që të nxierë fletëvotimet jashtë vendvotimit që të votojnë persona te moshuar dhe anëtarët e komisionit e kanë përzgjedhur Slobodan Trajkovic për shkak të transparencës dhe i njejt i ka nxierr fletvotimet jasht dhe i ka kthyer prap brenda.

Aleksander Stojkovic ka pranuar të njejtën ankesë nga KZAP-i sikur që ka pranuar edhe policia dhe iu është përgjigjur më datë 16.07.2010.

Lidhur me këtë ankesë policia ka kontaktuar edhe me Prokurorin Publik, Z. Xhymshiti Xhyshiti dhe i njejt ka thënë se këtu nuk ka elemente penale kundër Lirisë dhe të Drejtave të Njeriut nga (nenet 176,177,178,179,180 dhe 181) dhe ka sugjeruar që ta mbyllin këtë ankesë me një raport të veçantë dhe ta informojnë Prokurorinë Komunale Publike –Gjilan.

Kësaj shkrese iu kanë bashkangjitur kopjen e ankesës, përgjigjen në ankesë si dhe raportin policore me nr. #6667 të datës 09.08.2010.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

KZAP-i në pajtim me nenin 4.3 të Rregullores së Punës të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa i dha mundësi Z. Aleksaner Stojkovic më 14 korrik 2010 të jepte shpjegimet e tij për ngjarjen, gjë që e ka bërë më datë 16 korrik 2010. Prandaj, në përgjigjen e tij, anëtari i KKZ-së në mënyrë të qartë ka shpjeguar ngjarjen duke mohuar pretendimet e parashtruesit të ankesës, duke theksuar se Këshilli i VV unanimisht ka marr vendim që në rastin e përmendur të lejohet votimi jashtë VV.

Ligji Për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP (Ligji nr 03/L- 073) neni 118.1, parasheh si vijon:

KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6 pika (c) parasheh si vijon:

Hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njejtat nuk janë në posedim të ankuesit;

KZAP-i konstaton se Ankesa është e pabazuar sepse ajo është në kundërshtim me raportin policor të datës 09.08.2010, dhe se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur dëshmi bindëse.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

A nr. 201/2009 më datën 25.08.2010.

